



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, propozon që:

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 3 dhe 4 Udhëzimit administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2026 të miratojë këtë:

PROPOZIM

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI-KKSB

Neni 1

Me këtë Vendim themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Lipjanit, (në vazhdim të tekstit KKSBB), në përbërje si vijon:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës –Kryesues i KKSBB-së
2. _____, Komandant i Stacionit Policor,
3. _____, Bashkësia Islame
4. _____, Kisha ortodokse
5. _____, Kisha katolike
6. _____, komuniteti shqiptar
7. _____, komuniteti serb
8. _____, komuniteti turk
9. _____, komuniteti ashkali
10. _____, komuniteti, rom
11. _____, komuniteti kroat
12. _____, Kryesuesi i komitetit për komunitete
13. _____, Zyra për barazi gjinore
14. _____, Drejtori i Drejtoratit për Arsim
15. _____, Kryetar i Këshillit të prindërve
16. _____, përfaqësues nga FSK
17. _____, Këshilli Lokal për siguri publike,

18. _____, Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi
19. _____, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
Sektori i emergjencave civile
20. _____ Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
21. _____ nga OJQ

Neni 2

Në rast të mungesës së Kryesuesit në ndonjë takim, takimin e kryeson Nënkryetari i Komunës me të drejta dhe përgjegjësi të plota ashtu siq i ka Kryesuesi i KKS-së.

Neni 3

KKS-ja mban më së paku gjashtë (6) mbledhje në vit, tri (3) prej se cilave duhet të mbahen në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik. KKS-ja mund të mbledhet edhe më shpesh ose në bazë të nevojës të dhe kërkesave.

Neni 4

Mandati i anëtarëve të KKS-së është i njëjtë me atë të anëtarëve të Kuvendit Komunal.

Neni 5

Detyrat, përgjegjësitë, mbledhjet dhe çështjet tjera që lidhen me punën e KKS-së janë të përcaktuara me dispozitat e Udhëzimit administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Neni 6

Për punën e tyre anëtarët e KKS-së kompensohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për ta miratuar këtë Propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 3 dhe 4 Udhëzimit administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i dates 24.12.2021.

Nga të cekurat më lartë propozojmë miratimin e këtij Vendimi.

1Nr. 016/01-4872
Lipjan, më 29.01. 2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

